



# RAPORTI VJETOR I PUNËS SË AGJENCISË SHETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

VITI 2019

Më poshtë është paraqitur aktiviteti i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2019, bazuar në objektivat dhe drejtimet kryesore të punës së institucionit:

### **1. Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.**

Plotësimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit ka sjellë një klimë pozitive në kudër të bashkëpunimit ndërsektorial. Të gjithë aktorët janë të njohur tashme me detyrimin ligjor për raportim të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe procedurën që duhet të ndjekjë çdo profesionist në raportim. Krahasuar me vitin 2018 vërehet një rritje në numrin e rasteve të raportuara nga shkollat, qendrat shëndetësore, policia etj.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj ASHDMF, monitoron çdo ditë median e shkruar dhe vizive online lidhur me identifikimin e rasteve dhe çështjeve për fëmijët e abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, dhunuar etj. Përveç medias ASHDMF shqyrton raportimet nga institucionet dhe ankesat e qytetarëve që referohen në Agjenci nëpërmjet rrugës zyrtare shkresore apo e-mailit zyrtar të institucionit.


Gjatë 2019, ASHDMF ka identifikuar dhe ka referuar për ndjekje pranë NJMF-të përkatëse, **70 raste** në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto kanë qenë kryesisht raste fëmijësh të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, për të cilët është ndërhyrë menjëherë. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet nga NJMF përgjegjëse, nën monitorimin dhe supervizimin e ASHDMF.

Ndonëse detyra e ASHDMF është monitorimi dhe dhënia e ndihmës teknike për menaxhimin e rastit, në disa raste, kryesisht raste të abuzimit seksual, për shkak të natyrës së rëndë të abuzimit dhe vështirësisë së paraqitur, ASHDMF jo vetëm ka dhënë mbështetje teknike e ka koordinuar institucionet qendrore e vendore, por ka zbritur në terren për të vlerësuar situatën, ka mbledhur aktorët dhe ndihmuar konkretisht në hartimin e planit të mbrojtjes për fëmijën dhe menaxhimin e rastit (*Shiko Aneks 1*)

Bazuar në Ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, NJMF raportojnë pranë ASHDMF periodikisht çdo tremujor të dhënat statistikore që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse. Këto të dhëna përfshijnë fëmijët në territorin e bashkisë dhe njësive administrative në juridiksionin e saj. ASHDMF monitoron punën e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve në të gjithë vendin.

Për vitin 2019 kanë raportuar 61 NJMF. Këto raportime përfshijnë informacionin për punën e 236 PMF. Për vitin 2019 NJMF-të kanë menaxhuar **2449 raste në total**, ku nga këto **1078 janë raste të reja**.


**Grafiku Nr. 1: Numri i rasteve të menaxhuara nga NJMF, Viti 2019**



Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raporton NJMF e bashkisë Tiranë, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësive administrative. Numër të madh rastesh kanë raportuar edhe bashkitë Peshkopi, Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër, Pogradec, Kamëz.

Përsa i përket numrit të rasteve të reja të identifikuar sipas grupmoshës, vihet re një numër më i madh i fëmijëve të grupmoshës 13-15 vjeç, me 246 raste të reja për vitin 2019, ndërkohë grupmosha 0-3 vjeç ka pasur numrin më të vogël të rasteve, me 141 raste.


**Grafiku Nr. 2: Numri i rasteve të reja sipas grupmoshës, Viti 2019**



Nga 1078 raste të reja të identifikuar këtë vit, 196 raste janë fëmijë nga etnia rome janë dhe 135 raste janë fëmijë nga etnia egjiptiane.

Djemtë zënë numrin më të madh të rasteve të reja të identifikuar me 52 %, ndërkohë femrat me 48 %.

**Grafiku Nr. 3: Numri i rasteve të reja sipas gjinisë, Viti 2019**




Aktorët institucionalë në nivel vendor, shoqëria civile, familja dhe komuniteti kanë qënë aktivë në identifikimin e rasteve. Numri më i madh i rasteve është identifikuar nga NJMF, 319 raste si dhe strukturat e policisë që kanë raportuar 196 raste.

Vetë fëmijët kanë referuar dhunën pranë strukturave përgjegjëse, 19 raste. Prindërit dhe familjarët po marrin gjithmonë e më tepër një rol aktiv në referimin dhe denoncimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve duke raportuar 121 raste.

Institucionet arsimore dhe shëndetësore kanë qënë më aktivë në identifikimin dhe referimin e rasteve, përkatësisht 74 raste të identifikuar nga institucionet arsimore dhe 25 raste nga institucionet shëndetësore.


Kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin problematikave kanë dhënë mediat, qytetarët, skuadrat e terrenit për fëmijët në situatë rruge, gjykata, prokuroria etj. duke shënuar një numër prej 180 rastesh të referuara për vitin 2019. Në grafikun më poshtë, këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë”.

**Grafiku Nr. 5: Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar, Viti 2019**



Gjatë procesit të menxhimit të rastit, NJMF raportojnë mbylljen e 546 rasteve në total. Vihet re se një numër i madh prej 296 rastesh, janë mbyllur si rezultat i reduktimit të nivelit të rrezikut, çka do të thotë një rritje e kuptueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore. Kjo e dhënë tregon se janë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhet fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut.


**Grafiku Nr. 6: Numri i rasteve të mbyllura, Viti 2019**



Nga raportimet rezulton se në përgjithësi NJMF trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme, përkatësisht 831 dhe 1216 raste.

Gjithashtu, NJMF kanë menaxhuar 283 raste me rrezikshmëri të lartë dhe 119 raste në situatë emergjente.

**Grafiku Nr. 7: Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut, viti 2019**



Problematikjat e fëmijëve në nevojë për mbrojtje kanë qënë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Theksojmë se “Varfëria” apo “Problemet ekonomike në familje” në vetvete, nuk janë kritere të mjaftueshme që NJMF-të të hapin procesin e menaxhimit të rasteve. Por nëse fëmijët që jetojnë në kushte të tilla, përjetojnë mohim apo mungesë aksesit në shërbime, atëherë ata merren në mbrojtje nga NJMF. Për vitin 2019 janë menaxhuar 972 raste të tilla, ose 40% e rasteve në total.

Fëmijët në situatë rruge mbeten një nga problematikat më të trajtuara nga NJMF-të. Rastet më të shumta janë në Tiranë, Shkodër Elbasan, Kamëz. Numri më i madh i rasteve janë identifikuar nga skuadrat e terrenit në bashkitë ku zbatohet plani i veprimit për fëmijë në situatë rruge. Ngritja dhe funksionimi i skuadrave të terrenit është realizuar në zbatim të planeve lokale për fëmijë në situatë rruge.

Për vitin 2019 NJMF kanë marrë në mbrojtje 339 fëmijë të neglizhuar (14%). Shumica e tyre vijnë nga familje me probleme të theksuara ekonomike, familje ku prindërit i kanë braktisur ose vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Rastet më të shumta janë në qytetet Tiranë, Fier, Shkodër.

244 fëmijë ose 10% e rasteve në total janë marrë në mbrojtje për shkak të dhunës psikologjike, fizike dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve. Dhuna psikologjike shihet si forma më e përhapur e dhunës.

Raportimi i dhunës seksuale ndaj fëmijëve është rritur në krahasim me të dhënat e vitit të mëparshëm, rreth 29 fëmijë janë marrë në mbrojtje. Abuzimet me fëmijët janë kryer nga persona të njohur apo të afërm, të cilët kanë besimin e fëmijëve apo familjeve të tyre.


35 fëmijë me aftësi të kufizuara, janë marrë në mbrojtje nga NJMF kryesisht për të siguruar aksesin në shërbime dhe arsimimin e tyre. Megjithatë vërejmë se kanë filluar të dalin në pah problematika të tjera që lidhen me abuzimin fizik ose seksual të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjatë 2019 janë trajtuar 55 raste të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile.

Nisur nga legjislacioni i ri për të drejtat e fëmijëve si dhe Kodi i ri Drejtësisë Penale për të Mitur, NJMF kanë filluar të trajtojnë edhe rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin. Për herë të parë, në 2019 janë marrë në mbrojtje 64 fëmijë në konflikt me ligjin. NJMF-të kanë ndërhyrë duke hartuar dhe zbatuar plane riintegrimi për këta fëmijë, referim në institucione arsimore, vizita në familje, referim te zyrat e punësimit apo kurset profesionale etj.

Problematika të tjera si: kujdestaria, bullizmi online, sjellje devijante, riatdhesimi nga vendet e BE, fëmijë të huaj të pashoqëruar, janë trajtuar gjithashtu nga NJMF. Ndonëse secila problematikë është paraqitur në shifra të vogla, në total këto janë 190 raste ose 8% e totalit.

**Grafiku Nr. 8: Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave, Viti 2019**



Një nga risitë që solli ligji 18/2017 ishte aplikimi i masave të mbrojtjes nga NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit.

Për vitin 2019 NJMF kanë aplikuar 100 masa emergjente të mbrojtjes, për largimin e menjëhershëm të fëmijës nga familja dhe vendosjen në një mjedis tjetër të sigurtë. Ndërkohë gjithashtu janë marrë 31 masa e mbrojtjeje për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative si dhe 90 masa mbrojtjeje për mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

## **2. Mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge**

Gjatë 2019 janë ngritur skuadra terreni në 22 bashki të vendit (Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Bulqizë, Elbasan, Fier, Krujë, Kavajë, Himarë, Selenicë, Peqin, Pogradec, Ersekë, Maliq, Divjakë, Gramsh, Mat, Roskovec, Pustec, Berat) të cilat kanë identifikuar **272 raste të fëmijëve në situatë shfrytëzimi ekonomik** dhe janë referuar për shërbime pranë strukturave përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Në bashkëpunim me MASR, 45 fëmijë që më parë lypnin dhe punonin në rrugë, janë referuar dhe frekuentojnë rregullisht shkollën për vitin shkollor 2019-2020.

Puna në terren për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve bëhet bazuar mbi një kuadër ligjor tashmë të plotësuar, i cili rregullon këto procedura, VKM Nr. 129 “Per procedurat e identifikimit, referimit dhe mbrojtjes se femijeve nga shfrytezimi ekonomik”, Plani Kombëtar për mbrojtjen e femijeve nga shfrytezimi ekonomik si dhe plane lokale të cilat orientojnë bashkitë në objektiva konkrete në mbrojtje të fëmijëve të shfrytëzuar për punë dhe lypje. Në bashkëpunim me Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe organizatave partnerë, ASHDMF ka realizuar aktivitete dhe takime ndërgjegjësuëse me fëmijë, komunitet dhe profesionistë për mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve të cilët detyrohen të lypin dhe punojnë. Plani Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik dhe trafikimi është miratuar me Vendim Nr. 704, datë 21.10.2019 nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe është bërë i njohur për të gjithë bashkitë e vendit

Nëpërmjet projektit të përbashkët ndërmjet ASHDMF dhe OSBE, lidhur me çështjet e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, është mbështetur bashkia Bulqizë në hartimin dhe miratimin e Planit lokal për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Plani është miratuar me vendim të përbashkët të Drejtorit Rajonal të Policisë, Arsimit, Punësimit dhe Kryetari të Bashkisë Bulqizë.

ASHDMF ka organizuar takime në nivel vendor vendore në bashkitë Pukë dhe Malësi e Madhe për prezantimin e kuadrit ligjor mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Planit Kombëtar dhe legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. ASHDMF në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri kanë realizuar takime në bashkitë Vlorë, Bulqizë, Roskovec, Berat me tematikë “Takim ndër-vendor tematik për çështjet e rentës minerare” – prezantim i impaktit social të rentës minerare



Gjatë sezonit të verës, fokus të vecantë kanë pasur dhe organizimi i kampeve verore në bashkitë ku po zbatohen planet lokale për fëmijë në situatë rruge, ku pjesë e të cilëve kanë qenë dhe fëmijët e identifikuar në situatë rruge.

Vendi ynë është angazhuar për të dhënë kontribut në realizimin e Agjendës 2030 në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të). *Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 8.7* nxit shtetet të marrin masa të menjëhershme dhe efektive për të zhdukur punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne, trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve. Në këtë kuadër Aleanca 8.7 është një partneritet global, i organizuar për të identifikuar prioritetet dhe inisiativa të ndryshme, me qëllim përshpejtimin e progresit drejt arritjes së OZHQ 8.7.

Në **12 prill 2019**, ASHDMF, MSHMS në bashkëpunim me ILO dhe Prezencën e OSBE-së në Shqipëri organizuan një takim që synonte të prezantonte Aleancën 8.7 si dhe të identifikonte prioritetet, angazhimet kombëtare për të përshpejtuar progresin drejt arritjes së OZHQ 8.7.

### **3. Mbrojtja e fëmijëve të riadhesuar**

Me miratimin e VKM Nr.111, datë 06.03.2019 “Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin e Riadhesimit të Fëmijës së Pashoqëruar” ASHDMF është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes.

Nga momenti i miratimit të Vendimit dhe deri më dhjetor 2019 **janë riadhesuar 33 fëmijë** kryesisht nga Suedia dhe Gjermania. Janë në **proces vlerësimi për riadhesim 78 fëmijë**.

Fëmijet e riadhesuar janë përgjithësisht të seksit mashkull dhe moshë e tyre varjon mesatarisht nga 16 vjeç dhe lart.

Rastet referohen për vlerësim tek punonjësit për mbrojtjen e fëmijës panë bashkisë ose njesise administrative ku banon familja e fëmijës që do të riadhesohet.

Përgjithësisht fëmijët të cilët riadhesohen priten nga prinderit ose kujdestarët e tyre ligjor. Janë trajtuar 2 raste të fëmijëve të huaj të pashoqëruar të identifikuar në territorin e shtetit Shqiptar. Fëmijët kanë qenë nga Aganistani dhe Pakistani. Aktualisht kjo kategori fëmijës vendosen parë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, Babrru Tiranë e cila është një qendër për të rritur, ku është pershtatur një mjedis për fëmijet.

Aktualisht në vend janë 236 PMF. Moshëzbatimi standardit nga bashkitë, 1 PMF për çdo 3000 fëmijë është një sfidë shumë e madhe. Ka një fluks të madh të fëmijëve shqiptarë që riadhesohen. PMF duhet të vlerësojnë familjet e tyre në terren dhe të monitorojnë për një periudhë 6 mujore fëmijët që riadhesohen.

#### 4. Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital

Një nga prioritetet aktuale të ASHDMF është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në mjedisin dixhital. 18 raste të dhunës online ndaj fëmijëve, kryesisht në faqe sociale (Youtube, Instagram, Facebook) janë raportuar pranë Agjencisë nga linja ALO 116 111. Mbrojtja online e fëmijëve është një problem më i gjërë se kaq. Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual online I fëmijëve është një problematikë që po trajtohet me kujdes në Shqipëri dhe vendet e BE.

Një studim i kryer nga IPSOS dhe UNICEF Shqipëri eksploron përvojat e fëmijëve dhe prindërve nëpër dimensione të ndryshme të përdorimit të tyre të Internetit. Prindërit janë të informuar mbi identifikimin e rrezikut dhe mënyrave për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital.

Raporti i rasteve të dhunës online behet pranë ALO 116 111, që është një shërbim 24/7 pa pagesë për të gjithë fëmijet. Rastet e abuzimit, bullizmit online kanë marrë këshillim psikosocial dhe janë referuar pranë organeve përgjegjëse për trajtimin e tyre. Rastet janë referuar edhe pranë ASHDMF. Po gjatë kësaj periudhe 6,260 fëmijë janë ndërgjegjësuar në nivel kombëtar në të gjithë vendin për shërbimin e ALO 116 111.

ASHDMF në bashkëpunim me Save the Children ka përgatitur portalin “Zeri i Fëmijëve” ku do të ketë edhe një hapsirë për raportim nga vetë fëmijet, të rasteve të dhunës e abuzimit online dhe offline.

#### 5. Monitorimi dhe koordinimi i shërbimeve në zonat e prekura nga tërmeti

Në periudhën e fundvitit të 2019, puna e ASHDMF, si dhe e shumë institucioneve të tjera, u fokusuar në dhënien e ndihmës për familjet dhe fëmijët e prekur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. ASHDMF iu bashkua përgjigjes së qeverisë shqiptare për koordinimin e ndihmës humanitare në zonat e prekura nga tërmeti.

Në bashkëpunim me shumë aktorë nga institucionet dhe shoqëria civile janë akomoduar **1669 fëmijë**, nga familje të prekura nga tërmeti. ASHDMF ka qenë e angazhuar çdo ditë në terren në bashkitë Durrës, Shijak, Laç, Krujë, Vorë, Lezhë, Fushëkrujë, Shëngjin, Golem, Manzhë, Bubq, Thumanë. Sidomos ditët e para monitorimi dhe koordinimi është kryer me dy turne, paradite dhe gjatë natës.

Në zbatim të Urdhrit nr. 410/1 prot, datë 27.11.2019, të Kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, stafi i ASHDMF ka qenë i angazhuar çdo ditë në terren në ato vende ku janë sistemuar familjet dhe fëmijët e prekur nga tërmeti, në bashkitë Durrës, Shijak, Laç, Krujë, Vorë, Lezhë, Fushëkrujë, Shëngjin, Golem, Manzhë, Bubq, Thumanë. Ditët e para monitorimi dhe koordinimi u krye me dy turne, paradite dhe gjatë natës. Puna ka konsistuar në vlerësimin e situatës së fëmijëve dhe koordinimin e aktorëve që punojnë pranë hoteleve ku janë strehuar familje me fëmijë me qëllim evidentimin e nevojave emergjente materiale (ushqime,

veshmbathje, produkte higjenosanitare, etj.) si dhe evidentimi i problematikave kryesore në menaxhimin e situatës pranë çdo hoteli.

ASHDMF, kanë qenë e pranishme në zonat e përmendura më sipër, për të koordinuar bashkëpunimin mes organizatave dhe Urdhrit të Psikologëve. Qëllimi ishte verifikimi i situatës së fëmijëve dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike post-traumatike sa më shpejt pas gjendjes së krijuar si dhe identifikimi i nevojave të tjera të fëmijëve.

Pas kalimit të fazës së emergjencës humanitare qasja është drejtuar në ngritjen e një mekanizmi në nivelin kombëtar, përgjegjës për të koordinuar ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve në situata emergjente. Ky mekanizëm sot është ngritur, kryesohet nga MSHMS me mbështetjen e disa partnerëve si UNICEF, Eorld Vision, OSBE, ADRA, ALO MIK, Terre des homes, Save the Children, SHIS, Sanita di Frontiera etj.

## **6. Nxitja e bashkëpunimit dhe forcimi i kapaciteteve të NJMF dhe aktorëve lokalë**

### ***6.1 Aktivitete informuese në terren***

Në kuadër të nxitjes dhe sensibilizimit të aktorëve lokalë për mbrojtjen e fëmijëve ASHDMF gjatë periudhës shtator – dhjetor 2019 ka realizuar vizita në terren në bashkitë të ndryshme, me focus bashkitë me numër të vogël raportimesh të rasteve, bashki që paraqesin problematika gjatë procesit të menaxhimit të vrastit dhe bashkitë në zona të thella të vendit. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime në **15 bashki** ( *Poliçan, Krumë, Dropull, Malësi e Madhe, Memaliaj, Kukës, Belsh, Kuçovë, Divjakë, Lushnje, Patos, Roskovec, Gramsh, Tiranë, Korçë*)

Takimet koordinuese janë zhvilluar me **45 aktorë lokalë** në bashkitë e më sipër. Fokusi kryesor ka qenë nxitja dhe aktivizimi i aktorëve vendorë pjesë e GTN me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm si policia, shërbimet sociale, arsimit, shëndetësia, shoqëria civile etj)

Gjatë takimeve koordinuese në bashkitë me raportim të ulët të rasteve, sidomos nga sektori i shëndetësisë dhe arsimit, por dhe me aktorë të tjerë, ASHDMF ka zhvilluar biseda ndërjegjësuese, duke informuar aktorët mbi legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurat që ndiqen në menaxhimin e rasteve. Gjithashtu është theksuar detyrimi për raportim dhe përgjegjësia e secilit në rast mosraportimi. Janë zhvilluar gjithashtu bashkëbisedime me aktorët mbi rastet që u janë paraqitur, si janë menaxhuar këto raste nga ana e tyre dhe këshilla e sugjerime për veprime të mëtejshme.

### ***6.2 Konferencë Kombëtare e Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve.***

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatave partnere, të cilat operojnë dhe kanë kontribut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në Shqipëri, UNICEF, OSBE-së, Save the Children, Terre des hommes dhe Eorld Vision në datë 25 – 26 prill 2019, organizuan Konferencën “Koalicioni Kombëtar në

mbështetje të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës”. Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i risive ligjore në fushën e të drejtave të fëmijës dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave lidhur me hartimin e një plani kombëtar për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë vendin. Në konferencë morën pjesë mbi 150 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës nga 61 bashki të vendit, Drejtorë të Drejtorive të Shërbimeve Sociale nga 61 bashki, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, dhe përfaqësues të organizatave UNICEF, OSCE, ËV, TdH, SCiA. Gjatë konferencës U diskutuan risitë ligjore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, detyrimet për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, sfidat dhe mangësitë kryesore, lidhur me kapacitetet, koordinimin, identifikimin, menaxhimin dhe raportimin e rasteve, si dhe i metodat më të përshtatshme për mbështetjen e PMF-ve.

## **7. Monitorimi i të drejtave të fëmijëve**

### ***7.1 Monitorimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve në raportimet e medias***

ASHDMF monitoron në mënyrë të përditshme mediat me qëllim evidentimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në raportimet e mediave të shkruara dhe audiovizive. Rastet e shkeljes së të drejtave referohen pranë autoriteteve përgjegjëse me synim përmirësimin e situatës mediatike të raportimet të rasteve të fëmijëve. Hartohen raporte javore me përmbledhje të lajmeve ku janë të përfshirë fëmijët të cilat ndahen me aktorët përkatës.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2019 janë evidentuar **11 raste** të shkeljes flagrante të të drejtës së fëmijës, gjatë raportimeve në media audiovizive dhe në media sociale. Rastet janë referuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), si dhe pranë subjekteve publikë. AMA ka reaguar me shpejtësi duke i dërguar shkresë zyrtare dhe tërheqje vëmendje drejtur televizioneve, për shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu shkresë u është dërguar dhe subjekteve politike apo publikë për të cilët ka pasur ankesa për të cilët ka patur ankesa pranë Agjencisë.

### ***7.2 Takim me aktorët nga mediat dhe partnere në fushën e të drejtave të fëmijëve lidhur me çështjet e zbatimit të çështjeve etike në media.***

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve mori pjesë në Tryezën e Diskutimit “Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive”, organizuar në 26 mars 2019. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga OSHMA-të, Zyra e Komisionerit për të Dhënat Personale, Inspektoriat Shtetëror i Punës, Këshilli Shqiptar i Medias, Observatori për Mbrojtjen e Fëmijëve, Aleanca për Barazinë Gjinore etj.

Me rastin e 20 vjetorit të AMA-s, Instituti Shqiptar i Medias me mbështetjen e AMA-s organizoi konferencën “Fëmijët dhe Edukimi Mediatik përballë sfidave të reja”

ASHMDF mori pjesë në këtë konferencë dhe parashtrroi problematikat që lidhen me publikimin e rasteve të fëmijëve në media, respektimin e etikës dhe parimin e interesit më të

lartë për fëmijët në transmetimet audiovizive. Gjithashtu u prezantuan ndryshimet ligjore për fëmijët dhe referimin që mediat duhet të kenë në këto ndryshime gjatë transmetimeve ku janë të përfshirë fëmijët.

ASHDMF mori pjesë në tryezën e përbashkët të diskutimit, me temë “Fëmijët në median audiovizive”, të organizuar nga Grupi i Deputetëve “Miq të fëmijëve” në Kuvendin e Shqipërisë, në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA). Takimi u organizua më datë 12 korrik 2019, në funksion të zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit për AMA-n. Përfaqësuesja e ASHDMF ishte e pranishme në këtë aktivitet bashkë me aktorë të tjerë si deputetë, përfaqësues të mediave audiovizive, përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore, etj. Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ishte krijimi i një hapësire të dobishme për të diskutuar me të gjithë grupet e interesit, mbi aspekte të mbulimit të problematikave që lidhen me raportimin e fëmijëve në median audiovizive.

Në dhjetor 2019 ASHDMF ishte pjesë e tryezës së diskutimit mbi gjetjet e raportit të monitorimit “*Etika e videoklipeve muzikore dhe ndikimi tek adoleshentët*”.e realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në partneritet me Autoritetin e Medias Audiovizive AMA. Ky monitorim synonte të identifikonte problematikat që lidhen me çështjet e etikës dhe ndikimin në edukimin dhe botëkuptimin e adoleshentëve përmes transmetimit të videoklipeve dhe këngëve të transmetuara në median audiovizive në lidhje me etikën e tekstit dhe pamjeve, përmbajtjen e mesazheve që nxisin shfaqjet e dhunës verbale në zhargonin mes vetë të rinjve, përplasjet fizike, përdorimin e armëve, apo përdorimin e drogave dhe stimulantëve.

### ***7.3 Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijëve nëpërmjet mbledhjes së të dhënave statistikore në nivel kombëtar.***

Bazuar në ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” ASHDMF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe INSTAT. Në bazë të VKM Nr. 636, datë 26.10.2018”*Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDMF e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor*, Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore nga Ministrinë e Linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT bazuar në listën e treguesve bashkëlidhur këtij vendimi.

Treguesit janë të ndarë në 6 fusha, mbrojtja sociale, arsimit, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna/abuzimi fizik, shëndetësia, aksesit në drejtësi dhe drejtësia për të mitur. Agjencia ka bashkëpunuar me ekspert të UNICEF për ndërtimin e një platforme dixhitale online për paraqitjen e të dhënave lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve. Në vazhdimësi ASHDMF po punon me UNICEF për ngritjen e sistemit dhe hedhjen e të dhënave dhe informacionit statistikor zyrtar në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve në vite.

## **8. Pjesmarrje në takime dhe përgatitja e raportimeve ndërkombetare**

### ***8.1 Raportime në kuadër të integrimit evropian***

Gjatë periudhës janar – korrik 2019, ASHDMF Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës të ngritura në kuadër të procesit “screening” për përafrimin e legjislacionit kombëtar me acqius të BE ka dhënë kontributin e saj lidhur me analizën e direktivave të BE që kanë të bëjnë me fëmijët.

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij janë analizuar në kuadër të Direktivave të BE, për 4 kapituj të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Konkretisht gjatë procesit të punës janë plotësuar Tabelat e Kapaciteteve Administrative dhe Tabelat e Përputhshmërisë (LGA) për direktivat që kanë të bëjnë me fëmijët për Kapitujt:

- Kapitulli 19 “Politikat Sociale dhe Punesimi” në bashkëpunim me institucionin udhëheqës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore” në bashkëpunim me institucionet udhëheqëse, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Punët e Jashtme dhe Integrimin Evropian
- Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe institucionin udhëheqës Ministrinë e Brendshme
- Kapitulli 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti” në bashkëpunim me MSHMS dhe institucionin udhëheqës Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

ASHDMF, si pjesë e grupit të punës, ka kontribuar edhe në hartimin e Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2020 - 2022.

Në 6 maj 2019 Shqipëria raportoi në Seancën e 33 të Rishikimit Periodik Universal të Këshillit të Drejtave të Njeriut (UPR) ku paraqiti përpjekjet aktuale për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet në lidhje me të drejtat e njeriut duke vlerësuar zhvillimet pozitive dhe identifikuar sfidat. Kryetarja e ASHDMF raportoi lidhur me realizimin e angazhimeve për të drejtat e fëmijëve, legjislacionin e ri, aktet e reja nënligjore dhe masat e marra.

Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021) ka identifikuar si një ndër fushat prioritare mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në mjedisin dixhital. Në këtë kuadër është ndërmarrë projekti “End Online Child Sexual Exploitation and Abuse @ Europe”, që synon të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet bashkëpunimit efektiv multi-kombëtar, ndërdisiplinor dhe ndërsektorial dhe marrjes së masave të përshtatshme për fëmijët për të parandaluar dhe luftuar shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve të lehtësuara nga TIK (OCSEA) në nivel pan-evropian.

Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si përfaqësuese e shtetit Shqiptar për çështjet e fëmijëve në Këshillin e Europës, është caktuar si koordinator kombëtar për këtë projekt dhe ka marrë pjesë në Konferencën "Bashkëpunimi ndër-sektorial për

parandalimin dhe luftimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet", të organizuar në kuadër të këtij projekti, në periudhën 16-17 maj 2019 në Strasburg, Francë. Në konferencë morën pjesë edhe ekspertë të fushës nga institucionet shqiptare si: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Gjatë periudhës 8-12 korrik 2019, Kryetarja e ASHDMF ka marrë pjesë në një vizitë studimore të zhvilluar në Leiden/Holandë, në kuadër të programit “*Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Konflikt me Ligjin*”, që po zbatohet nga Terre des hommes Shqipëri (Tdh), në partneritet me Defence for Children International the Netherlands (DFC-NL), të financuar nga Qeveria Hollandeze nën programin MATRA. Vizita kishte në fokus njohjen me sistemin holandez të mbrojtjes dhe drejtësisë së fëmijëve dhe do të ndihmojë në identifikimin e mënyrave, praktikave të mira dhe modeleve me qëllim përmirësimin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin brenda sistemit të mbrojtjes dhe drejtësisë në Shqipëri.

Në Nëntor 2019, është marrë pjesë në takimin e grupit të punës të End of OCSEA të organizuar nga Këshilli i Europës, ku Shqipëria dha informacion mbi zhvillimet dhe programet që po implementohen në vendin tonë me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e abuzimi online.

## ***8.2 Bashkëpunim për hartimin e raportit të fëmijëve për CRC***

Agjencia ka qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të pestë Periodik të shtetit Shqiptar për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, lidhur me zbatimin e Konventës së OKB “Për të drejtat e Fëmijës”. Hartimi i raportit është koordinuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Europën. Agjencia ka hartuar materialin me të dhëna narrative dhe të dhëna statistikore lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend për periudhën 2012-2018. Janë dhënë komente mbi draftin e parë të raportit, gjithashtu gjatë kësaj periudhe stafi i Agjencisë ka dhënë komente dhe për variantin përfundimtar të raportit i cili është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **9. Aktivitete sensibilizuese dhe aktivitete në kuadër të ditëve të shënuara**

Në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Qendra Kombëtare për Internet të Sigurt e CRCA Shqipëri, Platforma Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet [www.ISIGURT.AL](http://www.ISIGURT.AL) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Child and Youth Policy Hub, AKEP, ECPAT Shqipëri, AITA dhe ABCOM organizuan Forumin Kombëtar për Sigurinë në Internet. Në këtë forum u diskutua mbi situatën e sigurisë së fëmijëve në internet, ndryshimet ligjore dhe mënyra e bashkëpunimit për sigurinë online për fëmijët.

Në **8 Mars, Diten Ndërkombëtare të Gruas**, u organizua Samiti i parë i vajzave në Shqipëri, të organizuar nga MSHMS, që ishte kurorëzimi i një përpjekjeje disa mujore për të sjellë 30 vajza dhe 16 deputete dhe aktiviste të shoqërisë civile, së bashku për fuqizimin e vajzave. Agjencia mori pjesë në këtë Samit.

Në kuadër të **12 Prillit, Ditës Ndërkombëtare për Fëmijët në Situatë Rruge**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me ILO dhe Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, organizuan një konferencë ku u prezantua Aleanca 8.7, si dhe indentifikuan prioritetet, angazhimet kombëtare, për të përshpejtuar progresin drejt arritjes së Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 8.7.

Me rastin e **1 qershorit**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, organizoi një takim të fëmijëve me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ogerta Manastirliu.

Gjatë takimit u prezantua versioni miqësor për fëmijët i Ligjit “Për të Drejtat e dhe Mbrojtjen e Fëmijës”. Fëmijë biseduan me ministren dhe sollën në mënyrë simbolike “zërin” e të gjithë fëmijëve në takim. Ata diskutuan për të drejtat e tyre, për ligjin e ri për fëmijët. Fëmijët pjesëmarrës frekuentonin qendrat ditore të bashkisë Tirane si dhe qendra të tjera që drejtohen në bashkëpunim me organizatat partnere të Koalicionit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ministria informoi që për herë të parë fëmijët do të jenë pjesë e Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve.

Në kuadër të **12 qershor 2019, Ditës Botërore Kundër Punës së Detyruar**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me bashkinë Tiranë, organizuan një aktivitet pranë Qendrës Sociale Multidisiplinare për fëmijë në situatë rruge. Fëmijë dhe profesionistë dhanë mesazhe mbi të drejtat e fëmijëve, në vecanti mbrojtjen e tyre nga puna e detyruar.

Në kuadër të **18 Nëntorit Ditës Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual**, ASHDMF në bashkëpunim me COD, AKCESK dhe disa nga fëmijët e shkollave të Tiranës organizoi një aktivitet sensibilizues. Në fillim u lancua një video sensibilizuese e pëgatitur nga Këshilli i Europës lidhur me mbrojtjen nga abuzimi seksual. Aktiviteti u drejtua nga fëmijët. Ata ndërvepruan me njëri-tjetrin me lojën “E-Loja për Sigurinë Online”, një quiz që testonte njohuritë e tyre në këtë fushë. U bë një paraqitje e shkurtër e një fact- sheet lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri në 30 vjetorin e Konventes së të Drejtave të Fëmijëve.

Në kuadër të parandalimit dhe nisur nga rasti i abuzimit seksual në Kavajë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkinë Tiranë dhe Linjën e Këshillimit Alo 116 111 ka organizuar takime informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës, mësues, psikolog, punonjës social dhe bordin e



prindërve në disa shkolla 9 vjecare dhe të mesme në bashkitë Tiranë dhe Kamëz. Qëllimi i takimit ishte për të diskutuar në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi dhe mënyrën e raportimit të këtyre rasteve pranë institucioneve përgjegjëse. Gjatë takimit u diskutua dhe për abuzimet e fëmijëve online, fëmijët dhe interneti, abuzimi seksual, dhe bulizmin. Përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijës theksuan forcimin e bashkëpunimit mes NJMF-së, shkollës, komunitetit dhe policisë për t'iu përgjigjur situatave abuzuese qofshin ekzistuese ose të dyshuar të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Përgjatë muajit tetor, në kuadër të muajit kundër trafikimit, në bashkëpunim me 61 bashkitë e vendit janë organizuar aktivitete në kuadër të muajit anti trafik .

Janë zhvilluar takime sensibilizuese me nxënës dhe mësues në shkollat 9 vjecare në bashkitë Malësi e Madhe, Divjakë dhe Gramsh. ASHDMF shpërndau informacion mbi të drejtat e fëmijëve, informacion mbi mekanizmat dhe strukturat e angazhuara për mbrojtjen e tyre, u theksua rëndësia e raportimit në çdo rast kur ndihen të dhunuar. Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë dhe fletëpalosje të KEDNJ si dhe broshura mbi raportimin online.

## **10. Mbështetja e ASHDMF me Burime Njerëzore**

Në kuadër të Planit të Aksionit midis Bashkimit Europian dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe UNICEF Shqipëri lidhën marrëveshjen e bashëpunimit me UNICEF me datë 13 Qershor 2019. Marrëveshja kishte për qëllim të kontribuonte në zhvillimin dhe forcimin institucional të Agjencisë nëpërmjet krijimit të një Ekipi Lëvizës që do të mbështesë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve me këshilla teknike dhe për të adresuar nevojat e tyre për fuqizim kapacitetesh në territorin ku ata veprojnë. Fokusi i punës së Ekipit Lëvizës konsistonte në arritjen e objektivave:

1. Rritje të raportimit të rasteve nga NJMF/PMF e bashkive që aktualisht raportojnë 0-3 raste, si dhe
2. Nxitja dhe inkurajimi i sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit për të rritur numrin e identifikimit dhe raportimit tek NJMF/PMF të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Në kuadër të projektit për fuqizimin e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë vendin, Ekipi Lëvizës gjatë periudhës Korrik 2019 – Qershor 2020 ka realizuar takime në bashkitë të cilat kanë pasur një raportim shumë të ulët të rasteve (1-3 raste) ose bashki të cilat kanë pasur raportim zero. Takimet janë organizuar me njësitë e mbrojtjes së fëmijës, si dhe me strukturat e shëndetësisë dhe arsimit për arsye të numrit të ulët të rasteve të raportuara nga këto struktura, por edhe me aktorë të tjerë lokalë të cilët janë në kontakt me fëmijët.

Duke nisur nga ngjarjet e emergjencave civile të ndodhur gjatë periudhës nëntor – dhjetor, puna ASHDMF ka ndryshuar fokusin në përshtatje të nevojave emergjente. Gjatë kësaj periudhe edhe puna e Ekipit Lëvizës është fokusuar në mbështetjen e ASHDMF për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve të prekur nga tërmeti. Janë realizuar takimet nëpër bashki të ndryshme me fokus nxitjen e koordinimit ndërmjet aktorëve vendorë në vlerësimin e nevojave dhe mbrojtjen e fëmijëve pas situatës së krijuar nga tërmeti.

## **REKOMANDIMET**

- Ka nevojë që të adresohen problematikat që lidhen me të gjitha format e dhunës offline dhe online. Dhuna fizike dhe abuzimi seksual janë format më të rënda të dhunës dhe kërkojnë vëmendje më të madhe gjatë menaxhimit të rasteve. Megjithatë së fundmi janë vërejtur edhe forma të tjera dhune si ngacmimi, bullizmi online, që kanë shfaqur problematika po aq të rënda tek fëmijët dhe familjet e tyre.
- Parandalimi i dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve duhet të marrë më shumë fokus, pasi aktualisht puna në terren është e përqendruar tek menaxhimi i rasteve të fëmijëve që kanë pësuar tashmë një nga format e dhunës.
- Identifikim i hershëm dhe proaktiv i fëmijëve që janë në situata të rrezikut për dhunë dhe abuzim, si dhe në situata të shfrytëzimit për punë. Profesionistët vendorë si mjeku, mesuesi, polici apo cdo profesionist tjetër që merr dijeni për ndonjë rast abuzimi me fëmijë, duhet të zbatojnë ligjin duke raportuar pranë policisë dhe NJMF.
- Ngritja e shërbimeve të reja të specializuara për kategori të veçanta të fëmijëve si: fëmijë të abuzuar seksualisht, fëmijë të huaj të pashoqëruar, fëmijë përdorues të lëndëve narkotike.
- Shtimi i numrit të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës në të gjithë vendin, duke plotësuar standartin ligjor 3000 fëmijë/ 1 PMF. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve duhet të punësohen sipas kriterëve ligjorë lidhur me edukimin, formimin profesional, pastërtinë e figurës
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorëve vendor mbetet domosdoshmëri. Lëvizjet e shumta të stafeve vendore të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve kërkojnë rritje të kapaciteteve profesionale të tyre në mënyrë të shpeshtë.

- NJMF/PMF është e nevojshme të mbështeten lidhur me trajtimin e fëmijëve që i përkasin grupeve të reja që duhet të merren në mbrojtje si: fëmijë në konflikt me ligjin (nën dhe mbi moshën e përgjegjësive penale), fëmijë të huaj të pashoqëruar, fëmijët që riatdhesohen etj.
- Rritje e vemendjes dhe mbështetjes për fëmijët që janë në familje me ndihmë ekonomike, shtresa e cila paraqet rrezik të shfrytëzimit seksual ose punës së detyruar. Bashkitë duhet të sigurojnë shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë nevojat për strehim, punësim dhe zhvillim urban të familjeve të varfra dhe me pamundësi ekonomike.
- Promovimi i buxhetimit me në qendër fëmijën, kryesisht në ofrimin e shërbimeve në nivelin lokal. Fondet lokale të bashkive duhet të kene një linjë buxhetore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- Orientimi i fondeve të donatorëve drejt përmirësimit dhe vendosjes së shërbimeve të drejtpërdrejta dhe efikase për fëmijët në nevojë.
- Mbështetje për familjet e fëmijëve që largohen nga kujdesi rezidencial gjatë procesit të deinstitutionalizimit – qendrat rezidenciale të transformohen në qendra që ofrojnë shërbim për fëmijët dhe familjen
- Rritja e stafit dhe buxhetit për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve si institucioni kryesor qeveritar i cili kujdeset për koordinimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.

## **Aneks 1**

### ***Mbështetje teknike në terren për rastin e abuzimit seksual në Kavajë***

Me urdhër të Kryetares së Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, u ngrit Grupi i Punës për kryerjen e procedurës së kontrollit lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore nga strukturat përgjegjëse lidhur me rastin e abuzimit seksual të vajzës 13 –vjeçare nga bashkëmoshatarët e saj, në bashkinë Kavajë.

Grupi i Punës realizoi vizita në terren për të identifikuar problematikat lidhur me punën dhe shërbimin e ofruar nga strukturat përgjegjëse. Pas verifikimeve të kryera në terren nga Grupi i Punës, rezultoi së kishte të dhëna për fillimin e procedurës për hetim administrativ lidhur me mënyrën sesi ishte tajtuar rasti nga aktorë të ndryshëm vendorë. me Urdhër të Kryetarit të ASHDMF Nr. 3 datë 04.02.2019, u ngrit Grupi i Monitorimit. Ky Grupi filloi procedurën e hetimit administrativ për kontrollin dhe vendosjen e sanksioneve, si dhe zhvilloi intervista me subjektet ndaj të cilëve kishte filluar procesi administrativ.

Në përfundim u vendosën masa administrative me gjobë për Zyrën Arsimore Kavajë, Znj Marjusa Cara, PMF, Bashkia Kavajë, Z. Tahir Okshtuni, Drejtor i Shërbimit Social, Bashkia Kavajë.

#### ***Mbështetje teknike në terren në bashkinë Përmet***

ASHDMF mori pjesë në takimin e grupit teknik ndërsektorial të organizuar në bashkinë Përmet, në bashkëpunim me zyrën e Ekstremizmit të Dhunshëm, lidhur me rastin e nje fëmije që nuk lejohej të shkonte ne shkollë nga prindërit. Rasti ishte problematik, pasi prindërit kishin probleme të shëndetit mendor. Agjencia realizoi takime me aktorë lokale: NJMF, zyrën juridike në bashki, shefin e komisarariatit të policisë, përgjegjësen e zyrës arsimore Përmet, mjekun e shëndetit mendor. Me ndërhyrjen e Agjencisë u arrit që rasti të menaxhohej dhe fëmijë t'i rikthehej shkollës.

#### ***Mbështetje teknike në terren në bashkinë Gjirokastrë***

ASHDMF mori pjesë në takimin e grupit teknik ndërsektorial të organizuar në bashkinë Gjirokastrë lidhur me rastin e një fëmije, i cili braktiste here pas here shkollën, dhe kishte tendencë për shfaqje të sjelljeve të dhunshme. Prindërit ishin të divorcuar dhe kishin shumë mosmarrëveshje lidhur me menaxhimin e situatës së fëmijës. ASHDMF bashkë me zyrën e Ekstremizmit të Dhunshëm mori pjesë në takimin ndërsektorial, ku dha udhëzimet e nevojshme për menaxhimin e rastit dhe bashkëpunimin mes aktorëve. Nga raportimi rezulton që fëmija frekuenton shkollën dhe merr trajtim psikologjik, me mbështetjen e bashkisë.

#### ***Mbështetje teknike në terren në bashkinë Krujë***

Me urdhër të Kryetares së ASHDMF, në maj 2019 u ngrit Grupi i Punës, për realizimin e monitorimit në terren lidhur me menaxhimin e rastit të vajzës 9 vjeç të dyshuar për abuzim seksual në Njësinë Administrative Bubq, referuar nga Linja e Këshillimit për Fëmijë Alo 116 111. ASHDMF ka realizuar takime me PMF Bubq dhe Fushë-Krujë, NJMF Krujë dhe Drejtoreshën e Shërbimeve Social në bashkinë Krujë, Drejtorin e shkollës, mësuesen kujdestare dhe psikologun e shkollës. Janë nxitur dhe këshilluar aktorët për mbledhjen e GTN. Nga diskutimet në GTN është vendosur të bëhet kallëzim për rastin pranë komisarariatit dhe vajza ka dhënë deklaratën në ambientet e komisarariatit në prezencën e psikologes. Çështja i kaloi prokurorisë për hetim. PMF në bashkëpunim me aktorët vendor kanë hartuar Planin Individual të Mbrojtjes me masat dhe ndërhyrjet e nevojshme. Familja në vazhdimësi do të mbështet me paketë ushqimore dhe me përgatitjen e dokumentacionit për tu trajtuar me KEMP dy prindërit.

Pas monitorimit të Grupit të Punës, Agjencia ka mbajtur kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Shërbim Social në bashkinë Krujë, dhe na bëjnë me dije se në bashkëpunim me PMF Bubq janë realizuar vita në familje dhe kanë shpërndarë paketë ushqimore për familjen. Është diskutuar me xhaxhin e fëmijës mundësia për vendosjen e vajzës në kujdestarinë e tij. Vajza frekuenton çdo ditë shkollën. Rasti do të monitorohet në vazhdimësi nga NJMF.